



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i  
Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology

Numër: 520101B  
Datë: 20/12/2018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), udhëzimin administrativ për ndarjen e bursave nr. 14/2017 i dt. 06.12.2017, nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), konkursin e publikuar me datë 19 Nëntor 2018, nxjerr:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e studentëve përfitues të bursës së Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin akademik 2018/2019.
2. Shuma e bursës për secilin student është 880.00(tetëqind e tetëdhjetë) euro.
3. Lista e studentëve përfitues është bashkangjitur në shtojcat e këtij vendimi.
4. Obligohet sekretari i përgjithshëm i MASHT për zbatimin e vendimit sipas legjislacionit në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, Udhëzimin administrativ për ndarjen e bursave nr. 14/2017 i dt. 06.12.2017, konkursin e publikuar me datë 19 Nëntor 2018 si dhe në bazë të raportit të komisionit të veçantë vlerësues për bursa, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Ministrit/MASHT;
2. Sekretarit të përgjithshëm/MASHT;
3. DASHT/MASHT;
4. Divizionit për buxhet dhe financa;
5. Arkivit.

